

## KONVENTA KOMBËTARE E INTEGRIMIT EUROPIAN

### Sesioni 1, Grupi Punës IV (Fondet Strukturore)

**Tema: Sfidat e Shqipërisë në Kapitullin 23 dhe menaxhimi i Fondeve të BE-së**

23 tetor 2020

#### Zhvillimet e fundit

- Bashkimi Europian është donatori më i madh në Shqipëri. Alokimet financiare nën Instrumentin e Para-Anëtarësimit - Programet Vjetore të Veprimit të Vendit, llogariten rreth 459 milion EUR në periudhën e programimit 2007-2013 (zbatimi i të cilave është ende duke u zhvilluar) dhe gjithsej 639.5 milion EUR për periudhën e programimit 2014-2020, me Demokracinë dhe Qeverisjen (32.6%), Konkurrenca, Inovacioni, Bujqësia dhe Zhvillimi Rural (28.6%) dhe Sundimi i ligjit dhe të Drejtat Themelore (20.9%) si tre sektorët më të mbështetur nga IPA II.
- Mund të vërehet se sektorët që janë përfitues tipik të fondeve për investime në infrastrukturë, përfitojnë nga alokimet financiare mjaft të kufizuara.
- Shqipëria gjithashtu merr pjesë në Programin që mbulon gjashtë Shtetet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqinë, nga të cilat më e rëndësishmja është 'Kadri i Investimeve i Ballkanit Perëndimor'. **Që me krijimin e këtij programi në 2009, Shqipëria ka marrë grante nga WBIF në vlerën prej 137.5 milion €, nga të cilat 124.8 milion € nga BE dhe 12.7 milion € nga donatorë të tjerë.**
  - Shqipëria gjithashtu merr pjesë në Programet e Bashkimit Europian, të tilla si Horizon 2020 dhe Erasmus, si dhe në 8 Programe të Bashkëpunimit Ndërkufitar dhe programe të tjera kufitare të financuara nga BE.
- Gjatë periudhës aktuale të programimit, Shqipëria po zbaton asistencën e BE-së sipas metodave të ndryshme të implementimit siç parashikohet në Rregulloren Financiare të BE-së:
  - Menaxhimi direkt**, me Komisionin Europian ose Delegacionin e BE-së në Shqipëri që vepron si Autoritet Kontraktues;
  - Menaxhimi indirekt me organizatat ndërkombëtare**, ku asistenca e BE-së zbatohet nga organizata ndërkombëtare të deleguara nga Komisioni Europian;
  - Menaxhimi indirekt me Shqipërinë**, ku asistenca zbatohet nga Shqipëria me AFCU/ Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë si Autoritet Kontraktues. Kjo metodë e

implementimit ka potencialin më të madh për rritjen e kapaciteteve dhe eksperiencës për strukturat dhe autoritetet shqiptare të përfshira në zbatimin e fondeve të para-anëtarësimit në BE.

- Sidoqoftë, në periudhën 2007-2013, 7.36% të totalit të alokimeve janë zbatuar përmes Menaxhimit Indirekt me shtetin përfitues. Për periudhën 2014-2020 ,10.84% e totalit të IPA II, deri në 2018, zbatohet përmes Menaxhimit Indirekt me shtetin përfitues.
- Gjatë periudhës aktuale të programimit, një pjesë e konsiderueshme e ndihmës zbatohet përmes 'Kontratave të Reformës Sektoriale', ku sipas të cilave, pagesat e kufizuara (rreth 10% e totalit) kryhen nga Komisioni si 'këste fikse', ndërsa shumica e pagesave - p.sh. këstet e ndryshueshme - janë të lidhura drejtpërdrejt me punën e autoriteteve shqiptare.
- Në këtë drejtim, **Shqipëria ka arritur përvojë të konsiderueshme në përcaktimin e treguesve dhe synimeve dhe në vlerësimin e kostos dhe kohën e arritjes së synimeve. Kjo përvojë do të shfaqet si unicum, ndërmjet shteteve të para-anëtarësimit.**
- Strukturat institucionale që ofrojnë asistencën e para-anëtarësimit në BE përfshijnë:
  - Zyra e Kryeministrit** që koordinon përgatitjen e strategjive të pasqyruara në Programin Buxhetor Afatmesëm (3-vjeçar, që përsëritet);
  - Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme**, në një rol koordinues. Ky institucion ka emëruar Koordinatorin Kombëtar të IPA-s i cili është homologu kryesor i Komisionit për procesin e përgjithshëm;
  - Ministria e Financave dhe Ekonomisë**, e cila ka emëruar **Oficerin Kombëtar Autorizues (NAO)**. **Njësia Qendrore e Financave dhe Kontraktimit (CFCU)**, një institucion publik në varësi të MEF-it, është Autoriteti Kontraktues për të gjitha prokurimet nën fondet e para-anëtarësimit të BE-së të menaxhuara në menaxhimin indirekt nga Shqipëria;
  - Departamenti i Koordinimit të Donatorëve** në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë siguron koordinimin e ndihmës së jashtme financiare për Shqipërinë;
  - 19 njësi të IPA të krijuara në Ministrinë e Linjës dhe institucionet e tjera publike**, në mënyrë që të sigurohet menaxhim teknik.
- Takimi shpjegues në lidhje me procesin e para-shqyrtimit për Kapitullin 22, është mbajtur në shkurt 2019, ku Komisioni paraqiti pyetësorin me 53 pyetje. Është

themeluar Grupi Ndërkombëtar i Punës (IWG), i Integritimit Europian **dhe tryeza e parë e këshillimit është organizuar në 08 korrik 2020.**

- **Institucioni koordinues për këtë grup ndër-institucional të punës është Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme**, institucionet e tjera të përfshira janë: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Zyra e Kryeministrit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Zhvillimit Rural.

### **Rekomandimet**

- Edhe pse Shqipëria ka fituar përvojë në menaxhimin e fondeve të BE-së, ajo gjithashtu është përballur me sfida e problematika në lidhje me zbatimin e vonuar dhe jo-angazhimin e fondeve të BE-së.
- Përveç procesit të përafrimit të legjislacionit në përputhje me reformat e miratuara me Komisionin, ekziston një nevojë për modernizimin e të gjithë vendit, duke nënkuptuar si strukturat e tij fizike, ashtu edhe atë jomateriale. Administrata publike duhet të forcojë kapacitetin e saj administrativ në përgjithësi, ndërsa në veçanti është e nevojshme **të zgjerohen kapacitetet e planifikimit dhe programimit; kapaciteti për të përgatitur dhe vlerësuar ex-ante investimet publike (duke ndërtuar kështu një bashkim të fuqishëm të projektit); dhe performanca e menaxhimit financiar dhe kontrollin e brendshëm.**
- Për të rritur kapacitetet në këto sektorë, Shtetet Anëtare të BE-së mund të mbështesin me ndihmë financiare dhe teknike, përfshirje në trajnime, me anë takimesh të përbashkëta dhe programesh që synojnë forcimin e kapaciteteve institucionale në këtë kapitull.
- Në krye të nevojës për të kaluar nga programimi vjetor, me shumicën e vendimeve të aprovuara ex-ante nga Komisioni Europian dhe veprimet e zbatuara drejtpërdrejt nga Delegacioni i Bashkimit Europian në Shqipëri, në autorësinë e plotë dhe përgjegjësinë e përdorimit të fondeve të BE pas anëtarësimit - sfida më e rëndësishme ka të ngjarë të jetë mungesa e një 'politike të mirëfilltë' për nëpunësit civilë të aftë dhe me përvojë të cilët janë trajnuar për zbatimin e fondeve të BE-së. Kjo çështje nuk ka zgjidhje të lehtë në kontekstin e kufizimeve aktuale fiskale të buxhetit kombëtar.

- Një rekomandim tjetër është përfshirja e grupeve të interesit si biznesi, shoqëria civile, organizatat, ekspertët dhe studiuesit në procesin e konsultimit në lidhje me miratimin e IPA III të planifikuar për periudhën 2021-2027. Nevojitet më shumë informacion dhe më shumë hapësirë për kontribut në lidhje me këtë instrument, në mënyrë që të vendosen në këtë program ato fusha dhe sektorë të vlerësuar si të rëndësishëm nga grupet e interesit.
- Është thelbësor miratimi i një analize të boshllëqeve mbi kapacitetet administrative dhe institucionale kur bëhet fjalë për programimin dhe zbatimin e fondeve IPA nga institucionet shqiptare.
- Rekomandohet që Shqipëria të hartojë dhe miratojë një politikë strategjike që mbulon një periudhë të gjatë kohe në mënyrë që politikat dhe qasjet të mos ndryshojnë sa herë që qeveria ndryshon, në mënyrë që programimi i fondeve të mos pësojë shumë ndryshime.
- Roli dhe përgjegjësia e institucioneve duhet të ndahet dhe të jetë shumë e qartë me një organ koordinues në mënyrë që të menaxhojë fondet në mënyrë efikase dhe procesi të mos jetë kaotik ose të vuajë nga vonesat, burokracia dhe moskoordinimi.
- Politika rajonale duhet të integrohet me atë ekonomike bazuar në objektivat afatgjata (gjithashtu nevojitet ekuilibri midis nivelit qendror dhe lokal).
- Sektori privat veçanërisht sektori i energjisë, mjedisit, turizmit, bujqësisë duhet të jetë një partner i fortë gjatë gjithë procesit dhe të gjitha politikat dhe strategjitë duhet të synojnë mbështetjen financiare dhe teknike të këtyre aktorëve.